



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.11.2018

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Vizitë pune Komisionit në Parkun Kombëtar të Butrintit.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Almira Xhembulla, Adelina Rista, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Bujar Çela, Anduel Xhindi (deputet zëvendësues).

Mungojnë:

Fatmir Velaj, Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj dhe Kejdi Mehmetaj.

Prezent:

Ledion Lako- drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës,

Orgest Feimi- drejtor i DRKK Vlorë,

Vladimir Demaj- Zyra e Ministrisë së Kulturës, Sarandë,

Pandi Zhonga - drejtor i Parkut Kombëtar të Butrintit,

Ambasadori Bernd Borchard - Kryetari i Prezencës së OSBE.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Mirëmbërëma të gjithëve!

Dua t'ju falënderoj për angazhimin që morët, edhe pse e premtë dhe darkë, për të lejuar Komisionin e Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik të bëjë një aktivitet parlamentar në Butrint!

Në veçanti, dua të falënderoj ciceronet e mrekullueshme që kishim, drejtorin e Butrintit, por edhe drejtorin e ministrisë, sepse pa ndihmën e tyre nuk do t'ia kishim dalë sot!

Në fakt, për ta bërë këtë aktivitet, të cilin kemi disa kohë që e kemi planifikuar, për të parë veprimtarinë kulturore, artistike, kërkimore dhe shkencore, që kanë bërë *site*-t tona të trashëgimisë kulturore, i kemi bërë një kërkesë zyrës së OSBE-së në Tiranë, për të mbështetur aktivitetin parlamentar. Jemi këtu falë mbështetjes që zyra e OSBE-së në Tiranë i bëri komisionit tonë në kuadër të të gjithë veprimtarisë parlamentare që zhvillojmë.

Kështu që, para se të kalojmë te pyetjet që duhet t'i bëjmë *site*-it të Butrintit për aktivitetin kulturor dhe kërkimor që ka zhvilluar gjatë vitit që shkoi, do t'ia jap fjalën ambasadorit të OSBE-së në Tiranë, që të na përshëndesë ose të na thotë dy-tri fjalë orientuese për këtë aktivitet.

Bernd Borchard – Mirëmbërëma të gjithëve!

Është kënaqësi të jem këtu.

Ne kemi punuar për të organizuar edhe vizitat të tjera. Kemi punuar që deputetët të dalin jashtë sallave të komisioneve dhe të organizojnë vizita të tilla.

Kemi bërë vizita në zonat që janë problematike për çështjet e mjedisit. E kemi bërë këtë me Komisionin e Mjedisit.

Me Komisionin e Sigurisë kemi vizituar pikat doganore me vendet fqinje dhe, sigurisht, edhe vizita e sotme me komisionin tuaj.

Qëllimi i këtyre takimeve është që ju, si deputetë, të mund t'i shihni këto zona kulturore, por njëkohësisht edhe personat që punojnë apo jetojnë këtu mund t'ju tregojnë anët pozitive, por edhe problemet me të cilat përballen në punën e tyre të përditshme.

Kemi parë se vizitat që kemi bërë me Komisionin e Sigurisë i kanë hapur pak punë Ministrisë së Punëve të Brendshme. Për ne ky është një rezultat pozitiv. Uroj që e njëjta gjë të jetë edhe me komisionin tuaj!

Faleminderit!

Milva Ekonomi - Faleminderit shumë, zoti ambasador!

Doja të konfirmoja se temat e takimit në *site*-t tona kulturore dhe artistike kanë një kornizë.

Në fakt, jemi bërë bashkë si komision për të pyetur për numrin e vizitorëve që ka pasur gjatë këtij viti, për të parë nëse numri i vizitorëve ka sjellë edhe rritjen e të ardhurave.

Sa nga këto të ardhura keni pasur mundësinë t'i përdorni për *site*-in?

Sa jeni detyruar t'i derdhni në Ministrinë e Kulturës ose në Ministrinë e Financës?

Çfarë marrëdhëniesh keni ndërtuar me njësitë e qeverisjes vendore?

Çfarë marrëdhëniesh keni ndërtuar me Ministrinë e Kulturës, nga e cila vareni?

Më pas, nëse jeni gati me ndonjë propozim për atë pjesë të nenit të ligjit të ri “Për trashëgiminë kulturore”, që detyron Ministrinë e Financave t'ju lejojë të përdorni të ardhurat e fituara në *site* për vitin e ardhshëm ushtrimor?...

Pak a shumë, këto pyetje do t'i bëjmë në çdo *site* dhe duam të bëjmë një raport final, për t'ia paraqitur Ministrisë së Kulturës.

Besoj se e shpreva qartë opinionin e të gjithë kolegëve të komisionit.

Kështu që do t'u bëja një ftesë drejtorëve...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ledion Lako – Zonja ministre donte të ishte sot këtu, por për shkak të një agjende jashtë vendit, më delegoi mua, si drejtor i Përgjithshëm i Politikave dhe i Zhvillimeve të Kulturës.

Në radhë të parë dua të falënderoj komisionin dhe ambasadorin!

Ky është një aktivitet që besojmë se ndihmon në zhvillimin e trashëgimisë kulturore, jo vetëm që komisioni parlamentar të shikojë nga afër bukuritë dhe atraksionet që kanë *site*-t tona, por edhe për të evidentuar problematikat dhe për të përmirësuar punën tonë për vitin 2019.

Ministria e Kulturës mendon se ky vit ka qenë shumë i suksesshëm për sa i përket sezonit veror. Ne kemi marrë masa dhe jemi duke u përgatitur që këtë vit, në mënyrë që viti tjetër të na gjejë edhe më të përgatitur dhe të kemi një standard edhe më të mirë, që të përmirësojmë ofertën tonë.

Për sa u përket pyetjeve, do të flas në përgjithësi për arritjet në të gjithë Shqipërinë, për numrin e vizitorëve dhe më pas do të dal edhe te *site* konkrete. Për pyetjet konkrete do të flasë vetë drejtori i parkut, i cili do të diskutojë për të gjitha çështjet që janë ngritur.

Për sa i përket numrit të vizitorëve dhe ndikimin e tij në rritjen e të ardhurave, për 10-mujorin e parë të vitit 2018, ka qenë 950 568 vizitorë vendas dhe të huaj në të gjitha *sitet*, monumentet e kulturës dhe muzetë e vendit tonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani po flas në përgjithësi. Më pas, do të flas konkretisht për Butrintin.

Milva Ekonomi – Të ardhurat kanë shkuar gati në 1 milion?

Ledion Lako – Po. Besoj se deri në fund të vitit do ta kalojmë këtë shifër, sepse kemi kohë edhe dy muaj të tjerë.

Analizat krahasuese dhe të dhënat statistikore me të njëjtën periudhë të vitit 2017 tregojnë rritje me 54%. Pra, është një rritje goxha e madhe krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Po ta krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit 2016, është 83%. Kurse nga viti 2014 ka një rritje me 158%. Pra, shikojmë rritje të numrit të vizitorëve në të gjitha parqet arkeologjike, muzetë dhe monumentet e kulturës.

Zë i rëndësishëm nuk është vetëm numri i vizitorëve, sepse kemi ditë që ne ofrojmë shërbime falas për vizitorët vendas dhe të huaj, por edhe të ardhurat. Të ardhurat për 10-mujorin e parë nga sitet, monumentet dhe parqet që ne kemi shkojnë në 190 milionë lekë të reja ose 1,5 milionë euro. Po ta krahasojmë me vitin 2017 do të shikojmë se në vitin 2017 ka pasur 136 milionë lekë të ardhura. Pra, një rritje goxha e larta krahasuar me vitin e kaluar.

Tani të flasim konkretisht për Parkun Kombëtar të Butrintit. Këtu kemi shifrat nga viti 2013-2017, që, nëse dëshironi, mund t'ia japim edhe komisionit tuaj. Gjithashtu, kemi edhe të dhënat për periudhën janar-tetor të vitit 2017 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Numri total i vizitorëve për 10-mujorin e parë të këtij viti ka qenë 209 691 vizitorë, kurse në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ka qenë 168 757 vizitorë. Pra, ka një rritje të konsiderueshme. Për sa u përket të ardhurave, krahasuar me 10-mujorin e vitit të kaluar, vetëm në parkun e Butrintit rritja e tyre është 32%.

Milva Ekonomi – Po në vlerë absolute ka ndonjë shifër?

Pandi Zhonga – Po, ka edhe në vlerë absolute. 63 000 809 ka qenë në 10-mujorin e parë të vitin 2017 dhe 83 929 000 gjatë 10-mujorit ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...është rritje e konsiderueshme. Kjo rritje ka ardhur për shkak të menaxhimit të mirë, promovimit të mirë, por edhe sistemeve të reja që ne kemi vënë. Në park ka biletari elektronike, e cila skanon çdo vizitor që hyn aty. Përveç kësaj, ka kamera, të cilat janë të lidhura me ministrinë dhe monitorohen nëpërmjet sistemit nga persona që punojnë në IT-në e Ministrisë së Kulturës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli – Domethënë, kamerat janë për sigurinë objektit, por në momentin që ndodh diçka, ai mund ta kontrollojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pandi Zhonga – Në momentin që ndodh një problem, patjetër që ...

Fidel Ylli – Kjo është vetëm për Butrintin apo edhe për... ?

Ledion Lako – Është për dhjetë site. Në bashkëpunim me ADP-në kemi vënë dhjetë biletari elektronike në këto site. Kjo ka çuar në rritjen e numrit të vizitorëve dhe të të ardhurave.

Fidel Ylli – Rritja ka ardhur sepse më parë nuk menaxhohej mirë apo tani është bërë ndonjë investim në kuadrin e pastrimit, apo diçka tjetër?

Ledion Lako – Është bërë punë e mirë, është promovimi që i është bërë gjatë gjithë këtyre viteve siteve dhe monumenteve të kulturës, por edhe mjetet e monitorimit që ndihmojnë për të pasur një kontroll më të mirë për vazhdueshmërinë e punës dhe për mbarëvajtjen e saj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Orgest Feimi – Gjatë verës kemi punuar me orë të zgjatura, gjë që ka rritur mundësinë e kohës së vizitueshme ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Turistët vendas e kishin 3 mijë lekë biletën, kurse të huaj 7 mijë lekë, pra 133% më shumë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pandi Zhonga – Lidhur me çështjen e ngritur, biletarinë, nuk kemi diferencim ndërmjet vendasve dhe të huajve. Për kategorinë “individ” çmimi është i unifikuar, 700 lekë të rinj personi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Biletat janë të ndara sipas kategorive: individ, familje, grup, si dhe kategorinë fëmijë, invalid ose pensionist.

Milva Ekonomi – Kur është dita e hapur, kur mund të vizitohet Butrinti? Keni një ditë të hapur, kur bileta nuk ka çmim?

Pandi Zhonga – Janë të përcaktuara festat sipas kalendarit, ndërkohë që duke përjashtuar tre muajt e verës, që është piku i sezonit, çdo e diel e fundit e muajit është falas. Në këto ditë të veçanta Butrintin kanë mundësi ta vizitojnë pa pagesë edhe vizitorët vendas, ndërkohë që e kanë edhe më afër. Sepse nuk duhet ta lënë Butrintin ta vizitojnë gjatë sezonit, ku edhe fluksi është më i madh, pasi edhe ne nuk kemi nevojë për të gjithë atë fluks turistësh. Ndodh që dikush vjen për plazh dhe thotë: “Hajt se po kaloj një xhiro edhe nga Butrinti”, sepse ka edhe turistë vizitorë, që nuk janë shumë të interesuar për trashëgiminë kulturore, ndërkohë që mbingarkojnë edhe Parkun disi artificialisht.

Ne kemi bërë vazhdimisht promovim për këto data, madje fillojmë që dy-tri ditë ose edhe një javë para. Çdo muaj publikojmë lajmin që këtë muaj, po themi, kemi tre ditë falas.

Milva Ekonomi – E publikoni në faqe apo e shkruani në gazeta?

Pandi Zhonga – E kemi në faqen e Institutit.

Milva Ekonomi – Po në televizor del?

Ledion Lako– Jo, në medie nuk është publikuar. Mirë është të kemi edhe këto, edhe faqet e Parkut. Ndërkohë, faqet analoge të ministrisë promovojnë qoftë Parkun e Apollonisë, por edhe parqet e tjera. Kështu që...

Fidel Ylli – Paratë që mbledhen nga biletat i përdor vetë *site*-i i Butrintit, apo i mbledh ministria dhe...?

Pandi Zhonga – Në rastin e *site*-it të Butrintit i përdor vetë Butrinti. Këtu futen të gjitha...

Fidel Ylli – Futen të gjitha? Nuk mban shteti ndonjë lloj takse?

Drejtori i Butrintit – Jo, sepse parqet bartin një status të veçantë.

Fidel Ylli – I mban 10%?

Pandi Zhonga – Zyra e Butrintit ia derdh buxhetit të shtetit.

Milva Ekonomi – Ndërsa 90% i mbani vetë? Domethënë, jeni ndryshe nga gjithë të tjerët?

Pandi Zhonga – Prej statusit të veçantë.

Fidel Ylli – Po të tjerët?

Pandi Zhonga – Të tjerët jo.

Fidel Ylli – E vë ministria?

Ledion Lako– Varet si e vë Ministria e Financave. Në disa raste e vë 10%, në disa raste të tjera e vë 70%.

Fadil Nasufi – Berati e ka 10%.

Ledion Lako - Pra, sipas të ardhurave që realizohen.

Fidel Ylli – Kush merr 90%?

Ledion Lako– Shteti.

Fidel Ylli – Kjo është pa lidhje fare.

Milva Ekonomi – Si e ndani këtë 90% që merrni? Sepse kur shtohet puna, kam përshtypjen se duhet të kesh të drejtën të kesh një bonus, duhet të kesh të drejtën për të bërë investime, duhet të kesh të drejtën për të bërë trajnime. A keni ndonjë procedurë se si i ndani apo se kush e vendos ndarjen e këtyre parave?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ledion Lako – Këtë e miraton bordi. Mblidhet bordi në ministri dhe për çdolloj problematike, pasi është paraqitur projekti. Pra, edhe ne kërkojmë thirrjen e bordit, i cili mblidhet dhe është pikërisht ai që vendos ku do të shkojnë këto investime. Në bazë të projekteve, ka për çdolloj problematike që është evidentuar. Pra, duhet të ketë një projekt konkret, i cili rrjedh si pasojë e një problematike, bie fjala cila është më emergjente, pastaj për këtë kërkohet mbledhja e bordit, i cili në fund miraton...

Milva Ekonomi – Të ardhurat në fund të vitit janë çështje rutinë. Mbaroi viti financiar...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më falni, sa të jap vetëm fabulën!

Mbaroi viti financiar dhe të ngelen 100 lekë. Nga këto 100 lekë, 10 ia derdh Ministrisë së Financave, ndërsa 90 i mban për vete. Në marsin e vitit pasardhës ti e di se sa para ke. Tani, menjëherë në mars do të mbledhësh bordin, duke i thënë: këto 90 lekë unë dua t'i jap. Me 2 lekë do të shpërblej stafin, sepse ka bërë një punë më të mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mirë, por kjo është punë ekstra. Ndaj shtroj pyetjen: a ka një gjë...?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më lini ta mbaroj!

Në më ngelen mua 88 lekë, të cilat dua t'i bëj trajnime për stafin, se me siguri të duhen trajnime për stafin...

Ledion Lako – Po.

Milva Ekonomi – ...do të më duhet të bëj mbrojtjen më të mirë. Ja, për shembull, një gjë që ne pamë ishte projekti inxhinierik që kishit nevojë për ujin, nisur nga parimi i enëve komunikuese, që ju jeni më poshtë sesa deti, ndaj ky i fundit ka për t'ju sjellë gjithnjë ujë.

Duhet një projekt inxhinierik për atë aspekt, apo jo, Ismet?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ndërkohë, a mund të bëhet kjo gjë me të ardhura dytësore, apo duhet të merrni leje gjëkundi? Kjo është njëra pyetje, ndërsa pyetja ime e fundit lidhet me atë që dëgjuam, se kjo zonë ka gjarpërinj. Kush jua merr përsipër juve dezinfektimin ose degjarpërizimin, nuk e di si quhet ajo gjë? Kush i lufton gjarpërinjtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pandi Zhonga – Dezinfektimin e mbulon Ministria e Shëndetësisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është nën monitorimin e Drejtorisë së Shëndetit Publik, madje këtë vit ka qenë shumë funksionale pjesa e menaxhimit, sidomos e mushkonjave, pra, përveç gjarpërinjve, sepse numri i gjarpërinjve është vërtet i madh, por unë kam pasur disa probleme me insektet dhe kryesisht mushkonjat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Milva Ekonomi – Po *antiviper*-a keni këtu?

Pandi Zhonga – Po, jemi të pajisur edhe me kutinë e ndihmës së shpejtë, ndërkohë... Kemi edhe granula që përdoren për kësisoj rastesh.

Gjatë gjithë itinerarit kemi numrat e emergjencës, pra në çdo pikë ku mund të ndodhë qoftë edhe ndonjë aksident apo pickim nga ndonjë gjarpër apo nga ndonjë insekt, janë telefonat e emergjencës.

Fidel Ylli – Sa veta është stafi i Parkut të Butrintit?

Pandi Zhonga – Janë 14 veta.

Fidel Ylli – Paguhet nga buxheti i shtetit?

Pandi Zhonga – Po.

Fidel Ylli – Po të ardhurat dytësore për çfarë i përdorni?

Pandi Zhonga – Të ardhurat dytësore përdoren për investime në fushën e mirëmbajtjes, duke diferencuar infrastrukturën, në radhë të parë.

Fidel Ylli – Këto i përcaktoni ju apo ministria?

Pandi Zhonga – Propozohet nga ana jonë. Në bazë të problematikave, përgatiten edhe projektet e caktuara. Në bazë të projektit del edhe vlera e çdo investimi dhe pasi miratohen projektet, thërrasim bordin dhe aty miratohet edhe si projekt, edhe si investim, nëse do të akordohet fondi apo jo, nëse qëndron dhe kështu përzgjidhen se cilat janë investimet më emergjente.

Pra, e ka bordi rolin vendimtar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, duke filluar që nga infrastruktura e parkut, pasi këtu jemi në qiell të hapur dhe dalin shumë probleme. Po ashtu, kemi mirëmbajtjen e monumenteve që nga konsolidimi i mureve, çdo ndërhyrje që mund të ketë nevojë një monument. Po ashtu, edhe rrjeti inxhinierik që vazhdimisht është i ekspozuar, duke filluar që nga rrjeti elektrik, rrjeti i kamerave, pasi këtu ka shumë shkarkesa nga rrufetë, mirëmbajtja e pyllit të këtushëm etj..

Vilma Bello - A keni nevojë për më shumë staf, kur ka fluks të madh turistësh?

Pandi Zhonga – Patjetër. Ne e kemi shtuar stafin.

Vilma Bello – Si e menaxhoni?

Pandi Zhonga – Ne e menaxhojmë duke përdorur eksperiencën, duke filluar që nga specialistët që janë aktualisht dhe kanë një eksperiencë të gjatë pune, se ata i dinë shumë mirë se ku janë pikat problematike.

Ndërkohë, punojnë me orë të zgjatura deri në orën 20:00 në periudhën e sezonit. Këtë vit po mundohemi, edhe në bashkëpunim me Bashkinë e Sarandës, për pastrimin edhe jashtë parkut. Këtë vit ka pasur një fluks të madh, deri në 3700 vizitorë brenda një dite dhe ka pasur problem me trafikun, se pati një dyndje të madhe. Ne po i përdorim të gjitha mekanizmat. Bëjmë edhe ndonjë prokurim.

Milva Ekonomi – Keni buxhetin e caktuar nga ministria apo përdorni vetëm të ardhurat dytësore? Siç e paraqitët ju kaq të vështirë, duket sikur ka pasur vetëm një buxhet. Është një buxhet apo janë dy buxhete?

Keni paga, keni edhe investime nga ministria.

Pandi Zhonga – Pagat janë nga buxheti i shtetit. Ndërkohë, kemi edhe një buxhet të akorduar në çdo fillim viti dhe nëpërmjet tij ne mundësojmë shërbimin e sigurisë fizike të parkut me anë të rojeve private. Pjesa tjetër përdoret për shërbime, për materiale sanitare dhe të gjitha ato që duhen, që nga lënda drusore etj..

Milva Ekonomi – Po internetin kush e paguan?

Pandi Zhonga – Edhe internetin me këtë buxhet e paguajmë vetë.

Milva Ekonomi – Me buxhetin e ministrisë?

Pandi Zhonga – Po.

Milva Ekonomi – Ju keni buxhetin nga ministria dhe të ardhurat dytësore.

Pandi Zhonga – Të ardhurat dytësore i përdorim vetëm në rastet, kur...

Milva Ekonomi – Domethënë ai buxhet nuk është juaji.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këtë më shpjegoni që ta kuptoj!

Fidel Ylli – Ka një bord në ministri që në bazë të projekteve, thith fondet. Ky të ardhurat dytësore nuk i merr vetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos flisni të gjithë menjëherë që të kuptojmë!

Pandi Zhonga – Çdo shpenzim tjetër e kemi nga të ardhurat tona, përveç pagave që përballohen nga buxheti i shtetit. Çdo shpenzim tjetër që kryen Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Butrintit, është nga të ardhurat e institucionit.

Orgest Feimi - Është njësia e menaxhimit më vete. Është bordi që mbledhet çdo muaj ose çdo 2 muaj për të parë problematikën dhe nevojat që ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Domethënë, buxheti juaj është relativisht i ulët në këtë rast.

Pandi Zhonga - Buxheti jonë është relativisht i lartë.

Milva Ekonomi – I lartë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pandi Zhonga – Ne kemi të ardhura të larta dhe 90% të këtyre të ardhurave të larta, janë për ne. Çalojmë disi në realizimin e buxhetit, sepse gjithmonë kemi ngërçe në miratimin e projekteve, sepse çdo gjë duhet të kalojë në Institutin e Monumenteve.

Fidel Ylli – Këto para që dalin nga Butrinti a mund t'i përdorë bordi?

Orgest Feimi – Jo.

Fidel Ylli – Janë 1,5 milionë euro.

Orgest Feimi - Nuk do të thotë që 1,5 milionë euro do të përdoren brenda një viti. Këto trashëgohen dhe po nuk u përdorën, nuk digjen.

Milva Ekonomi – Sa ide projektesh keni tani?

Orgest Feimi - Një projekt që është në fazën e miratimit është për furnizimin me ujë për Parkun e Butrintit nga ujësjellësi. Më parë nuk ka ekzistuar një lidhje e tillë. Tani jemi në këtë fazë. Meqenëse jemi një zonë arkeologjike, miratimi kalon në disa faza.

Milva Ekonomi – Nuk bëhet furnizimi me ujë së bashku me furnizimin me drita?

Orgest Feimi – Jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Janë dy furnizime të ndryshme, por është një punë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më dëgjoni pak! Ju po thoni që kjo gjë nuk bëhet, sepse ndërkohë duhet të merrni leje në disa vende.

Orgest Feimi – Thjesht vonon nga ana e procedurave. Janë në dy drejtime të ndryshme.

Milva Ekonomi – Janë dy procedura të ndryshme.

Orgest Feimi– Uji dhe energjia elektrike janë dy gjëra të ndryshme.

Milva Ekonomi – Nuk ka se si të jenë, sepse në Tiranë ne shohim që në një kanal të madh vendoset një tub i madh, ku kalojnë uji i pijshëm, kabllot e telefonit, të energjisë elektrike etj.. Në të njëjtin kanal kalojnë të gjitha...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju po hapni kanal in për ujin. Ju duhet edhe energjia elektrike, sepse e pamë që në site është errësirë. Ju kur e bëni këtë gjë, nuk e mendoni se mund t'i bëni bashkë, sepse nuk ka rëndësi se nga vjen burimi fillestar?

Orgest Feimi - Jo, nuk mund të bëhen bashkë, sepse ne jemi munduar që te projekti i furnizimit me ujë të shfrytëzojmë edhe rrjetin e brendshëm ekzistues. Pra, të mos prekim fare nëntokën, pasi kjo këtu është zonë arkeologjike dhe mund të dëmtohet gjatë procesit të gërmimit. Linja, në fakt, futet maksimumi rreth 200 metra, duke shkuar nga rrjeti ekzistues deri tek tualetet dhe shpërndahet tek të gjithë ku ka nevojë, ndërkohë që rrjeti elektrik ka drejtim tjetër.

Fidel Ylli - Unë kam një pyetje në lidhje me parkun, i cili tani është në errësirë të plotë. A do të vazhdojë të jetë kështu, apo ka nevojë për një rrjet ndriçimi, që edhe natën të ketë një pamje nga jashtë, sepse në orën 4 e gjysmë pasdite ishte errësirë? Si janë parqet e tjera në botë, me drita apo pa drita? Pse nuk ka ndriçim këtu te ne?

Orgest Feimi – Kjo gjë mund të shihet si një alternativë shtesë për të ndriçuar pjesën e itinerarit të monumenteve kryesore...

Fidel Ylli – Është gjithë ky park dhe ka nevojë për ndriçim brenda.

(Diskutime pa mikrofon.)

Pandi Zhonga - Këtë gjë ne e kemi propozuar edhe këtë vit, sepse kjo do të na ndihmonte shumë edhe në kohën e sezonit. Nuk është e nevojshme që të gjithë vizitorët të nxitojnë për ta parë brenda kohës që ka dritë natyrale, sepse ka shumë të interesuar që duan ta shikojnë në darkë, pasi ka tjetër magji natën.

Fidel Ylli – Unë mendoj se ndriçimi duhet bërë në bazën e një vizioni të një arkitekti që merret me këtë punë, sepse nuk mund t'i vendosësh vetë këto drita. Pra, kjo punë kërkon arkitektë të specifikuar për ndriçimin.

Pandi Zhonga – Kjo do të na çojë në një problematikë tjetër, sepse duhet të mendojmë për kapacitetet e stafit, pasi nuk mundemi ne që ta menaxhojmë.

Fidel Ylli - Mua më intereson vizioni që keni ju që menaxhoni, pastaj nëse kjo punë ecën mirë me ato të ardhura, atëherë le të shtohet stafi.

Orgest Feimi - Ne jemi në një fazë bashkëpunimi me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit së bashku me Ministrinë e Kulturës dhe me Parkun e Butrintit lidhur me planin e menaxhimit. Për të hartuar këtë plan menaxhimi është angazhuar një kompani angleze, e cila ka eksperiencë të gjerë në këtë fushë dhe brenda muajit maj plani besoj se do të jetë i përfunduar. Në bazë të këtij plani menaxhimi, pasi ata të evidentojnë të gjitha këto problematika, përfshirë edhe sugjerimin tuaj, që ndikon drejtpërdrejt në mënyrën e

menaxhimit, atëherë do të hartojnë, në mënyrë paralele, të gjitha projektet për të cilat ka nevojë Parku i Butrintit, që nga problemet parësore deri te momentet dytësore e të tjerë. Atëherë, ne mund të kemi një menaxhim më të mirë, pasi edhe dinamika e numrit të vizitorëve këto vitet e fundit, sidomos këtë vit, ka pasur një rritje shumë të madhe. Faktori kryesor është miradministrimi, duke filluar që nga viti i shkuar deri këtë vit, në të gjitha pikat kryesore, që nga monitorimi i kamerave, nga sistemi elektronik e të tjerë. Gjithashtu, rritja e çmimit të biletës ka ndikuar shumë mirë tek të ardhurat, madje po ta krahasojmë me sitet analoge në Europë, çmimi që kemi ne është shumë simbolik. Mua më ka rastisur kur kam shkuar në Akropol, në kulmin e sezonit, të paguaj 20 euro hyrjen për person ose për të vizituar një kështjellë normale në Skoci mund të paguash 15 ose 20 euro për person.

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Krahasimi që ju bëtë është shumë i fortë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Fidel Ylli – Po sa e ka rrogën në muaj ai që e viziton atje?

Orgest Feimi - 4 mijë euro.

Fidel Ylli – Po këtu? 400 euro!

Milva Ekonomi - Fakti që ju keni statusin e veçantë, ne të gjithë jemi të kënaqur që e keni këtë status, a i justifikoni të ardhurat krahasuar me sitet e tjera në Shqipëri?

Pandi Zhonga - Patjetër që i justifikojmë!

Milva Ekonomi– Si është krahasimisht? A jeni ju në vendin e parë?

Pandi Zhonga – Parku i Butrintit është në vendin e parë në rang vendi, sepse ka 650 mijë euro...

Po, janë 840 milionë lekë në 10-mujorin e parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E mira do të ishte që këto të ardhura të qëndronin tek thesari i Parkut të Butrintit dhe në momentin që duhet një plan menaxhimi, aty duhen të gjitha këto projekte. Po ashtu, qëllimi kryesor është të mbrohet dhe të ruhet ajo çfarë ke.

Milva Ekonomi – Ju keni pasur një plan menaxhimi afati i të cilit mbaroi në vitin 2007, nëse nuk gaboj.

Pandi Zhonga - Po, por ai ishte një plan menaxhimi mjedisor.

Milva Ekonomi – Gjatë gjithë kohës është diskutuar se do të kishte një plan të ri menaxhimi. A po fillon puna për hartimin e këtij planmenaxhimi?

Pandi Zhonga – Sapo e thashë, është në proces. Pra, studioja angleze është kontraktuar nga ADF-ja, Fondacioni Shqiptaro – Amerikan i Zhvillimit, dhe në bashkëpunim

me Ministrinë e Kulturës dhe me stafin e Parkut të Butrintit janë në procesin e hartimit të këtij plani. Përfaqësuesit e studios angleze vijnë rregullisht çdo fundmuaji dhe bashkë me specialistët tanë, si dhe duke marrë asistencën e specialistëve të ministrisë, monitorojnë dhe evidentojnë problematikat në terren.

Milva Ekonomi – Për sa vjet do të jetë i vlefshëm ky plan?

Pandi Zhonga – Atëherë, plani brenda vetes do të ketë edhe mundësi rishikimi për pika të caktuara ...

Milva Ekonomi – Sa vjeçar do të bëhet plani strategjik i menaxhimit?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të jetë për 6 vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fillon në vitin 2019 dhe është deri në vitin 2025.

Vilma Bello – Fillon edhe aplikimi sipas ligjit të ri të trashëgimisë.

Milva Ekonomi – Dakord, lidhet me këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fadil Nasufi – Gati në fund të sesionit të kaluar u miratua ligji “Për trashëgiminë kulturore dhe muzete”. Nga miratimi deri tani a kanë dalë aktet nënligjore? A kanë dhënë efekt implementimi direkt i investimeve për muzetë kulturore dhe për trashëgiminë arkeologjike?

Ledion Lako – Me miratimin e ligjit “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” ne kemi filluar punën me aktet nënligjore dhe deri më sot është bërë një punë voluminoze e Ministrisë e Kulturës. Deri tani kemi miratuar VKM-në nr. 582, datë 03.10.2018 “Për deklarimin e qendrës historike të qytetit të Tiranës”. Jemi duke punuar me zonën arkeologjike “A” dhe “B” të Durrësit, sepse edhe kjo zonë ka problematikat e saj të zhvillimit. Qytetarët duan të restaurojnë shtëpitë e tyre, por nuk mundën, sepse akti nënligjor dhe ligji i vjetër “Për trashëgiminë kulturore” i bllokonte pa asnjë logjikë, dhe thoshte: “Nuk lejohet ndërtimi”, duke e ditur që atje kemi të bëjmë me një zonë të mbrojtur, ku banojnë më shumë se 100 mijë banorë. Ligji i ri i ka dhënë zgjidhje këtij problemi, gjithmonë duke mbrojtur trashëgiminë kulturore. Pra, të gjitha punët që do të bëhen në këto zona të mbrojtura si për Tiranën, ashtu edhe për Durrësin, do të kalojnë në institucionet e Ministrisë së Kulturës për t’u miratuar, pastaj do të hapet rruga për restaurimin e tyre, kur janë monumente kulture, por edhe për rikonstrukcion, kur kemi të bëjmë me godina që janë në gjendje të keqe.

Kjo është një punë voluminoze, e cila është në proces dhe shumë shpejt ne do të miratojmë VKM-të e reja sipas prioriteteve që kemi për mbarëvajtjen e punës. Por kjo nuk na pengon në punën tonë, sepse deri në daljen e akteve nënligjore ne kemi mundësi të punojmë

me institucionet me atë mënyrë organizimi që ka qenë me ligjin e vjetër. Çdo gjë është funksionale për sa i përket qëllimit tonë në rolin mbrojtës dhe ruajtës të trashëgimisë kulturore. Po punojmë që të përshtatim aktet nënligjore me ligjin e ri të trashëgimisë kulturore.

Për sa u përket muzeve, ka pasur investime të rëndësishme, për shembull në Muzeun Arkeologjik të Durrësit është investuar për të bërë katin e dytë dhe të tretë dhe me ligjin e ri merr statusin e Muzeut Kombëtarë. Ky muze ka një rritje të madhe të numrit të vizitorëve.

Gjithashtu, Muzeu “Shtëpia me Gjethe” ka qenë një sukses dhe vazhdon të jetë. Për këtë muze ka një interes shumë të madh dhe numri i vizitorëve rritet çdo ditë, gjithashtu edhe në Muzeun Mesjetar të Korçës dhe në Muzeun “Marubi”. Pra, të gjitha këto muze janë kthyer në institucione, të cilat jo vetëm janë pika atraksioni turistik, por kanë një rëndësi të madhe për sa i përket interesit kulturor nga ana e vizitorëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi - Më vjen mirë që Parku Arkeologjik i Butrintit ka status të veçantë.

Pandi Zhonga -.....Parku ka status të veçantë.....për këtë arsye, jo se këtu nuk është investuar, investohet me punë, mirëmbajtje të vazhdueshme...

(Incizim shumë i dobët)

Ne diskutuam çështjen e ndriçimit që ka një kosto.....

Ismet Beqiraj – Në lidhje me çështjen e ndriçimi, nuk mund të zgjidhet nëpërmjet programeve të energjisë? Ndonjë projekt interesant, do të thosha, duke shfrytëzuar energjinë solare?

Orgest Feimi - Të gjitha këto do të jenë pjesë e planit të menaxhimit, i cili i bën të qarta...

Milva Ekonomi -si ke për t'i bërë, si ke për t'i marrë dritat?

(Diskutime pa mikrofon.)

Dakord, por e dinë ata. Nuk mund t'u japim ne mend. Të bëjmë pyetjet që duhen!

Ne vjet në komision u përballëm me një çështje tjetër që kishte të bënte me një ndërtim, në një pjesë të lartë, një zonë e cila mbante veglat e punës ose magazina, një objekt ekzistues. A mund të na jepni një informacion shtesë për këtë gjë? Ne dëgjuam të gjithë debatin dhe meqenëse jemi këtu...

Pandi Zhonga - Për fat të keq nuk na la kohë errësira për të shkuar.....ajo ndërhyrje edhe nga ana vizuale nuk kishte.....impaktit viziv që has vizitori në momentin e parë, në një kohë që është restauruar objekti ekzistues me një sipërfaqe jo më shumë se 50 metra katror.

Milva Ekonomi - Koncepti, është i njëjti si tualetet që keni bërë?

Pandi Zhonga –Aty është, nuk është ndërtim me dru, por është vendosur një platformë xhami, në formë L-je. Ky është objekti ekzistues; 50 metra katror është magazina e veglave, tani është restauruar. Ka qenë një objekt i ndërtuar në periudhën komuniste, nuk është se ka pasur ndonjë vlerë të veçantë. Në lidhje me xhamin, është menduar i tillë, që edhe vizitori impaktin e parë ka një kupë xhami transparent. Duke qenë se vizita zgjat minimalisht një orë e gjysmë në temperatura që arrijnë në verë 40 gradë, vizitori ka nevojë për një pikë shërbimi dhe rekreacioni, ku mund të marrë një shishe ujë, të hajë diçka të shpejtë, mund të ulet, pasi ajo është trajtuar si një qendër multifunkionale. Aty ka edhe një stendë me libra, ku vizitori, cili ka kohë në dispozicion, mund të ulet. Janë libra që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me Butrintin.

Milva Ekonomi - Këtë e menaxhoni ju?

Pandi Zhonga - Jo, ky është subjekt privat, në bazë të një rregulloreje të brendshme që ka hartuar Parku në bashkëpunim me Ministrinë.

(Diskutime pa mikrofon)

Faktikisht nuk kam pasur asnjë ankesë.

Ledion Lako -...sepse aktualisht nuk ofrohet shërbim dhe ka disa që ofrojnë shërbim privat, por në momentin që do ta ofronte shërbimin shteti apo në rastin konkret Parku, flitet për personel. Patjetër, ky është një nga problemet që kërkohet kjo marrëdhënie apo bashkëpunim me privatin.

Milva Ekonomi - Për shembull, meqenëse u përmend Anglia, Skocia dhe Akropoli, unë në Skoci nuk kam qenë, por kam qenë në Akropol dhe në përgjithësi pika shërbimi ka në hyrje të muzeve. Ka modele kur pika e shërbimit është jashtë itinerarit?

Ledion Lako – Jo, kjo është brenda territorit.

Milva Ekonomi- Brenda territorit është? ... Kështu funksionon? *(Diskutim pa mikrofon).*

Në fund të vizitës..... është jashtë.....

Specialistja - Para se të futesh në kala, në fund të itinerarit, te Belvederja është dhe një pikë shërbimi.

Ledion Lako – Jashtë... ofrojnë shërbim.

Milva Ekonomi - Në fund ose në fillim të sitit? Unë prandaj po bëj pyetjen, nëse është kështu apo jo.

(Diskutim pa mikrofon.)

Rreth e përqark, por jo në Kolose. Nuk ka në qendër të Koloseut. Ka shërbime që janë në një pjesë, por rrugën zbuluese nuk e ke, prandaj po bëjmë pyetje që a ekziston.

Përgjigjja që dha Ledioni që varet nga rasti dhe përgjigjja që dha vajza është që është në fund të vizitës.

Kjo është arsyeja që ju e keni bërë atje.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fidel Ylli – A ka asistentë të mbrojtjes nga zjarri, meqenëse është zonë e pyllëzuar?

(Diskutime mikrofon.)

Vilma Bello – Aktivitetet e mëdha që bëhen, si Festivali i Teatrove e të tjerë, sa ndikojnë këto dhe si është procedura për një që do të organizojnë një event këtu? A paguajnë ata një tarifë?

Orgest Feimi – Festivali i Teatrove e disa të tjerë janë të pavarur dhe i gjejnë vetë donatorët.

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Po dasma a bëhen këtu?

(Diskutime pa mikrofon.)

A janë te faqja web të dokumentuara këto evente?

Pandi Zhonga – Janë bërë edhe pagëzime.

I bëjmë promovim te faqet online.

Dasmat nuk është se i publikojmë, por këto të tjerat i paraqesim.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fidel Ylli – Ky klubi që u bë, a paguan ndonjë qira?

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Tek amfiteatri, a lexoni libra?

(Diskutime pa mikrofon.)

Pandi Zhonga – Ne sapo kurorëzuam një aktivitet për Festën e Mandarinës me nxënësit e shkollave të zonës, të cilët bënë interpretime nga veprat e Antikitetit.

Milva Ekonomi – Ne erdhëm këtu dhe e kuptuam si funksionon qendra juaj dhe përpjekjen që po bëni ju për të qenë aktivë, për të dhënë mendime tek aktet nënligjore të ligjit të trashëgimisë.

A keni nevojë të na thoni ndonjë gjë, që duhet të bëjmë për ju dhe ne ta ngremë si shqetësim?

(Diskutime pa mikrofon.)

Fidel Ylli – A ka mundësi të na tregoni se sa janë pagat tuaja në një sajt kaq të rëndësishëm sa ky?

(Diskutime pa mikrofon.)

Pandi Zhonga – Unë personalisht, që jam drejtor, marr 75 mijë lekë neto.

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Ju jeni te 7%-shi, apo jo? Këto lloj shërbimesh këtu, nuk janë te lista e 7%-shit. Te kjo listë janë mjekët, arsimtarët, diplomatët janë ushtarakët.

Këtu ka një funksion si mësimdhënie...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Prandaj e bëri pyetjen Fideli.

Fidel Ylli – Po në fund të vitit, a mund të marrin ndonjë bonus punonjësit që e menaxhojnë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ledion Lako – Në rastin e Butrintit kanë të drejtë t'i propozojnë bordit, i cili pastaj të vendosë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli – T'i thonë bordit, për vete “na e rrit rrogën”, ë?

Ledion Lako – Po e shpjegoj më thjesht: është gjysmë sh. a.

Fidel Ylli – Këta gjysmë sh. a.? Këta janë shtet komplet. Nesër ministria i heq me një laps plumbi, po të kërkojnë rritje rroge. Thotë: “hiqe atë, se do të sjell një të partisë atje”!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Orgest Feimi – Ne kemi pasur një problem. Më fal, drejtor, edhe miratimet e pagave, edhe miratimi i punonjësve shtesë bëhen... Ministria e Ekonomisë dhe e Financave nuk i sheh fare këto statistika. Ndërkohë, ne kemi pasur një problem: na janë akorduar vetëm dy punonjës sezonalë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kërkesa është bërë për dhjetë, por janë miratuar vetëm dy. Ministria e Ekonomisë dhe e Financave nuk i merr këto të dhëna për punonjësit, që të shohë se sa nevojë ka, sidomos për punonjësit sezonalë. Nuk po flasim për pagat tona, por të paktën me punonjësit sezonalë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Po tjetër shqetësim? Çfarë shqetësimi tjetër ka?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli – ... Falënderojmë ambasadorin, stafin, dhe të shpresojmë për një vit më të mirë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Siç e do praktika parlamentare, e gjithë kjo bisedë është incizuar. Ju e shikoni se është një vajzë që incizon. Ne e kemi për detyrë që këtë bisedë ta zbardhim dhe

nga biseda të nxjerrim rekomandimet, të cilat ua çojmë ministrive të linjës apo edhe komisioneve të tjera në parlament.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Derisa zbardhet, ajo vihet në *websajtin* e Kuvendit, ku është edhe e aksesueshme. Përveç kësaj, siç ju thashë edhe në fillim, do të bëjmë një raport të përgjithshëm, duke vizituar disa vende. Kemi bërë një planifikim edhe se ku do të shkojmë tjetër. Nesër do të shkojmë në Gjirokastrë, më pas do të shikojmë Muzeun Kombëtar në Tiranë, do të shkojmë edhe në Apolloni. Në Berat kemi qenë dhe e kemi një informacion në lidhje me Beratin.

Ndërkohë, për ne është shumë i rëndësishëm rekomandimi i parë. Kjo strategjia juaj paska një afat, që është muaji maj, ndaj le t'i rrihet mirë afatit. Gjëja e dytë e rëndësishme është që ju të keni një zë në lidhje me VKM-të që po projekton ministria. Po ashtu, edhe ne të kemi një zë, që të paktën, me zë shumë të fortë, t'i japim një lloj këshillimi ministrisë, që të shikojë pagat tuaja, të komunikojë me Ministrinë e Ekonomisë, që periudha e verës të jetë një periudhë në të cilën të miratohet stafi tre apo gjashtë muaj më shumë.

Gjëja tjetër është një sugjerim imi, meqenëse i kam ca eksperiencë në administratë. Duhet të shikoni pak edhe mënyrën si përdoren të ardhurat dytësore, se nuk lidhen aq shumë me numrin fiks të të marrëve në punë, që lejon Ministria e Ekonomisë dhe Financave me vendim të Këshillit të Ministrave; të lejon ty të marrësh aq punonjës nga fondi i pagave shtesë, por jo nga të ardhurat dytësore.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më kupton? Fondi i pagave të lejon ty të marrësh punonjës provizorë. Të ardhurat dytësore të japin një mundësi përdorimi sipas ligjeve që ka menaxhimi i ndërmarrjeve publike. Kështu, do të të lutesha shumë, që të bëni një vëzhgim në lidhje me këtë mundësi, me financimin që keni. Ejani të konsultoheni edhe me ne, në komision, që të bëjmë një propozim pak më të qenësishëm për ministrin e Ekonomisë, që të mos keni pengesa. Merre si detyrë, të lutem, mos më kthe përgjigje! Merre si detyrë bërjen e këtij vëzhgimi dhe hajde na tako, na shkruaj e-mail, kur të jetë për ta bërë këtë gjë. Dakord? Sepse unë e kuptoj, se duhet filluar puna që tani, me qëllim që vera t'ju gjejë me stafe shtesë, ngaqë kjo nuk mund të bëhet në mars, se në mars është vonë.

Dakord jemi? Faleminderit për të gjitha gjërat e mençura që na thatë! I falënderojmë shumë të gjithë pjesëmarrësit. Falënderojmë shumë edhe OSBE-në.

MBYLLET MBLEDHJA

